

Nr. i Dokumentit: 30-06- 2015-02

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Dragashit ('Komuna') për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2014, në emër të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikojnë rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni i ZAP-it është që "Të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike."

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1. Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	9
2. Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	11
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	19
4. Qeverisja.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara.....	35
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	38
Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të auditimit	43

Përmbledhje e përgjithshme


Hyrje

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Dragashit ("Komuna") për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ("ZAP").

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Komunës së Dragashit për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Deloitte Kosova sh.p.k. Ne do të donim të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 7 nëntor 2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga ne për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara.

Opiniononi i Auditorit është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet material, me përjashtim të çështjeve në vijim:

1. Në Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme janë paraqitur si pranime dhe pagesa shuma e mjeteve të realizuara/alokuara (shuma që është në dispozicion për t'u shpenzuar) në vlerë prej 7,190,000 Euro në vend të 6,607,016 Euro, gjë e cila nuk është në përputhje me Rregulloren MF - Nr. 03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore".

Për më tepër, shënimet e Pasqyrës së pranimeve dhe pagesave në para të gatshme përfshijnë shumat aktuale të pranimeve dhe pagesave të bëra në emër të LIVTH dhe prandaj shumat e paraqitura në shënime nuk përputhen me balancat e pasqyrës.

2. Në Pasqyrën e Ekzekutimit të Buxhetit si realizim janë paraqitur gabimisht të hyrat vetanake në vlerë prej 320,788 Euro në vend të 375,020 Euro sa kanë qenë për vitin 2014. Gjithashtu vlera e paraqitur në Shënimin 16 - "Grante dhe ndihma" nuk përputhet me vlerën e paraqitur në këtë pasqyrë e cila është më e lartë për shumën 141,000 Euro.

3. Duke qenë se Komuna nuk ka pranuar një raport zyrtar të detajuar prej agjensive qeveritare lidhur me investimet që ato kanë bërë në Komunë, ne nuk kemi mundur të marrim siguri të arsyeshme që të gjitha investimet e vitit aktual dhe viteve të mëparshme janë regjistruar dhe paraqitur në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të organizatës buxhetore "si dhe që investimet në fjalë janë në pronësi të Komunës.

Po ashtu, për shkak të mangësive në regjistrin e pasurive kapitale jofinanciare mbi 1,000 Euro, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi dhe respektivisht vlera neto e pasurive e prezantuar në shënim është e saktë.

Për më tepër, në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të Organizatës Buxhetore" pasuritë janë 46,000 Euro më të mëdha se sa vlerat e paraqitura në regjistrin e pasurive kapitale.

4. Komuna regjistron pasurinë jo-kapitale nën 1,000 Euro në posedim në një Excel file dhe jo në sistemin "E-pasuria". Po ashtu, Komuna nuk ka llogaritur zhvlerësimin për këto pasuri dhe ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse vlera neto e këtyre pasurive është siç është prezantuar në shënimin 32 "Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1,000 Euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit" është e saktë.


Cështje tjetër


Pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013, janë audituar nga auditor të tjerë të cilët kanë shprehur opinion të pakualifikuar për këto pasqyra me 6 qershor 2014.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







Përgjigja e Kryetarit të Komunës - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Kryetari i Komunës. Përgjigjet e Kryetarit, lidhur me çështjet për të cilat nuk kemi mundur të pajtohemi janë dhënë në detaje në Shtojcën III.

1. Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunes të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin tonë të auditimit. Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme dhe çështje që mund të kenë ndikim në humbjen dhe/ ose zotimin e të hyrave; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2. Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Auditimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne jemi përcaktuar për një opinion të kualifikuar. Ne kemi identifikuar dhe një numër të gabimeve të vogla jomateriale të cilat nuk kanë ndikuar në opinionin e auditimit por janë përfshirë si çështje në këtë raport. Obligimet e tjera për raportim të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF-të në përgjithësi janë përmbushur, përveç rasteve të përshkruara në pikën 2.3 të këtij raporti. Megjithatë opinionin e kualifikuar tregon se deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, të cilës i jemi referuar më lart, nuk ishte e saktë në të gjitha aspektet.

2.1. Opinioni i Auditimit

Për Komunën e Dragashit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Komunës së Dragashit (“Komuna”) të cilat përmbajnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënimeve tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin Financiar Sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme” dhe me Rregulloren MF – Nr.03/2013 “Për Pasqyrat Financiare Vjetore të organizatave buxhetore”. Kjo përgjegjësi përfshinë hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të kualifikuar të auditimit.

Baza për opinionin të kualifikuar

1. Në Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme janë paraqitur si pranime dhe pagesa shuma e mjeteve të realizuara/alokuara (shuma që është në dispozicion për t’u shpenzuar) në vlerë prej 7,190,000 Euro në vend të 6,607,016 Euro, gjë e cila nuk është në

përputhje me Rregulloren MF - Nr. 03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore".

Për më tepër, shënimet e Pasqyrës së pranimeve dhe pagesave në para të gatshme përfshijnë shumat aktuale të pranimeve dhe pagesave të bëra në emër të LIVTH dhe prandaj shumat e paraqitura në shënime nuk përputhen me balancat e pasqyrës.

2. Në Pasqyrën e Ekzekutimit të Buxhetit si realizim janë paraqitur gabimisht të hyrat vetanake në vlerë prej 320,788 Euro në vend të 375,020 Euro sa kanë qenë për vitin 2014. Gjithashtu vlera e paraqitur në Shënimin 16 - "Grante dhe ndihma" nuk përputhet me vlerën e paraqitur në këtë pasqyrë e cila është më e lartë për shumën 141,000 Euro.
3. Duke qenë se Komuna nuk ka pranuar një raport zyrtar të detajuar prej agjensive qeveritare lidhur me investimet që ato kanë bërë në Komunë, ne nuk kemi mundur të marrim siguri të arsyeshme që të gjitha investimet e vitit aktual dhe viteve të mëparshme janë regjistruar dhe paraqitur në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të organizatës buxhetore "si dhe që investimet në fjalë janë në pronësi të Komunës.

Po ashtu, për shkak të mangësive në regjistrin e pasurive kapitale jofinanciare mbi 1,000 Euro, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi dhe respektivisht vlera neto e pasurive e prezantuar në shënim është e saktë.

Për më tepër, në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jofinanciare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të Organizatës Buxhetore" pasuritë janë 46,000 Euro më të mëdha se sa vlerat e paraqitura në regjistrin e pasurive kapitale.

4. Komuna regjistron pasurinë jo-kapitale nën 1,000 Euro në posedim në një Excel file dhe jo në sistemin "E-pasuria". Po ashtu, Komuna nuk ka llogaritur zhvlerësimin për këto pasuri dhe ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse vlera neto e këtyre pasurive është siç është prezantuar në shënimin 32 "Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1,000 Euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit" është e saktë.

Opinion i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të çështjeve të referuara në paragrafin 1 dhe 2, dhe përveç efekteve të mundshme të çështjeve të referuara në paragrafin 3 dhe 4, siç përshkruhet në paragrafin Baza për opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me SNKSP për "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Rregulloren MF - Nr.03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të organizatave buxhetore".

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2013, janë audituar nga auditor të tjerë të cilët kanë shprehur opinion të pakualifikuar për këto pasqyra me 6 qershor 2014.

Deloitte Kosovo
Prishtinë, Kosovë

23 qershor 2015

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 7 nëntor 2014, janë identifikuar 3 rreziqe domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive. Gjatë kryerjes së auditimit, ne kemi identifikuar një tjetër rrezik në lidhje me përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit.

Rreziqet e anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive dhe përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare kanë ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë veprime për të adresuar rreziqet e paraqitura.

Çështja 1 – Mungesë e dokumentacionit të pronësisë për investimet e bëra nga agjencitë tjera qeveritare - Prioritet i lartë

Rreziku i identifikuar

Mungesë e dokumentacionit të pronësisë e cila mund të krijojë paqartësi lidhur me të drejtat e pronësisë së pasurive në mes të Komunës dhe të Agjencive të tjera të ndryshme të Qeverisë së Kosovës dhe vështirësi në shfrytëzimin e këtyre pasurive në të ardhmen.

Mungesat mund të rezultojnë në vlera materiale të pasurive që nuk përfshihen në PVF-të e Komunës ose përfshihen me vlera jo reale.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive dhe qartësimin e çështjeve të pronësisë për investimet e bëra nga Agjencitë e ndryshme të Qeverisë së Kosovës për vitin 2014 dhe vitet paraprake. Ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të ishte e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm dhe ne nuk kemi arritur të konfirmojmë nëse vlerat e pasurive të regjistruara në PVF janë të sakta.

Shënimi 31 “Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të organizatës buxhetore”: Komuna nuk ka pranuar një raport zyrtar të detajuar prej agjencive qeveritare lidhur me investimet që ato kanë bërë në Komunë gjatë vitit 2014 dhe as për vitet e mëhershme. Gjatë punës sonë, ne kemi vërejtur që investime të caktuara të bëra në vitet e mëparshme, janë regjistruar në pasqyrat financiare të vitit 2014, kur edhe janë pranuar dokumentet mbështetëse për to prej agjencive qeveritare. Gjithashtu ne kemi vërejtur investime të kryera gjatë vitit 2014, por të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2014 pasie dokumentet për to nuk janë pranuar prej agjencive qeveritare respektive gjatë 2014-ës.

Ne nuk kemi mundur të marrim siguri të arsyeshme që të gjitha investimet e vitit aktual dhe viteve të mëparshme janë regjistruar dhe paraqitur në pasqyrat financiare si dhe që investimet në fjalë janë në pronësi të Komunës.

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të analizojë arsyet për mangësitë e përshkruara më lartë të cilat formojnë një nga pikat për kualifikimin e opinionit dhe të identifikojë veprimet e duhura për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015.

Çështja 2 - Pasiguri në lidhje me plotësinë e notës "Shpalosja e Pasurive" dhe mungesë e një barazimi të informatave nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive - Prioritet i lartë

Rreziku i identifikuar

Shpalosja e pasurive nuk është e plotë për arsye se jo të gjitha pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë përfshirë në shpalosje. Lëvizja (shtesat) e pasurive mund të mos jetë në pajtim me informatat e prezantuara në Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar të lëvizjeve në vitet 2014 dhe 2013 për të mundësuar pajtimin e informatave të prezantuara në pasqyrat financiare. Si mungesë e këtij verifikimi në vitin 2014, Neni 12 paraqet shtesa në pasuri prej 2,163,471 Euro, ndërsa Neni 16 'Shpalosja e pasurive' tregon një rritje neto në totalin e pasurive në vitin 2014, prej 1,312,000 Euro. Kjo rritje nuk ishte detajuar dhe as barazuar me shtesat sipas Nenit 12.

Rekomandimi 2 Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme Komuna regjistron dhe prezanton në shënimin 31 "Përmbledhja e Pasurive jo-financiare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të Organizatës Buxhetore "të gjitha pasuritë, si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.

Çështja 3 - Mungesë e dokumentacionit të pronësisë për investimet e bëra nga palët e treta - Prioritet i lartë

Rreziku i identifikuar

Të dhëna jo të plota të pagesave nga palët e treta në sistemet qendrore të informacionit në përdorim të Komunës dhe mungesë e koordinimit dhe barazimit mes të të dhënave me palët e treta që mund të rezultojë me prezantim të mangët dhe me gabime të të dhënave në Pasqyrat e Komunës.

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Gjatë vitit 2014, nuk ka pasur ndonjë investim të bërë nga palët e treta në Komunë. Megjithatë duhet të ceket se as në vitin 2014 Komuna nuk ka pranuar një raport zyrtar të detajuar prej palëve të treta lidhur me investimet që ato kanë bërë në Komunë gjatë viteve të mëparshme.

Rekomandimi 3 Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bën përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e siguruar duhet të paraqiten drejtë në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika e mirë do kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës për investimet në Komunë për vitin përkatës.

Çështja 4 - Mangësi në përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare - Prioritet i lartë

Rreziku i identifikuar

Pasqyrat vjetore financiare mund të mos përgatiten në përputhje me kërkesat e Rregullores MF - Nr. 03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të organizatave buxhetore".

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi rishikuar masat e ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar që procesi i raportimit bëhet në përputhje me rregulloren përkatëse. Ne kemi rishikuar nëse raporti vjetor financiar përmbush kërkesat e Rregullores MF-Nr. 03/2013 dhe kemi vërejtur disa mangësi materiale të cilat janë pika për kualifikimin e opinionit. Një përshkrim i këtyre mangësive dhe disa mangësive tjera jomateriale janë të përshkruara në sesionin 2.3 më poshtë.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes të PVF-ve plotësisht adreson kërkesat e Rregullores MF - Nr. 03/2013. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve. Të gjitha kërkesat tjera të raportimit duhet të përmbushen.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare Nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së Nr. 03/L-048;
- Afatet e dorëzimit të raportimeve në MF;
- Kërkesat për nënshkrim të PVF nga ZKA ('Kryetari') dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Kërkesat për të përgatitur PVF në kopje elektronike dhe fizike;
- Dorëzimi i raportimeve tremujore tek Asambleja Komunale dhe MF;
- Raportet mbi obligimet e papaguara;
- Raportet operative (performancës vjetore);
- Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin paraprak; dhe
- Dorëzimi i Pasqyrat vjetore financiare në gjuhën shqipe dhe serbe.

Nga auditimi ynë kemi vërejtur që nga kërkesat e mësipërme Komuna nuk është në përputhje me kërkesat për pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare Nr. 03/2013, siç përshkruhet më poshtë.

Çështja 5 – Pajtueshmëria me Pasqyrat Vjetore Financiare – Prioritet i lartë

E gjetura Çështjet e ngritura në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar pjesërisht nga Menaxhmenti. Në kontekst të PVF-ve, ne kemi identifikuar mos pajtueshmërinë në vijim:

- Komuna në "Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme" ka paraqitur si pranime dhe shpenzime shumë të mjetëve të realizuara/alokuara (shuma që është në dispozicion për t'u shpenzuar) në vlerë prej 7,190,000 Euro përderisa është dashur të paraqesë si pranim shumë aktuale të shpenzimeve të bërë në emër të LIVTH në shumë prej 6,607,016 Euro.

Si pasojë e një paraqitjeje të tillë edhe shumat e shënimeve 2- Granti qeveritar, 3- Të hyrat vetanake, 4- Grantet dhe ndihmat, 7 - Paga dhe rroga, 8- Mallra dhe shërbime, 9- Shërbime komunale dhe 11 - Shpenzimet kapitale, nuk barazohen me shumat e paraqitura në këtë pasqyrë, pasi që në shënime janë paraqitur shumat e shpenzuara që është një paraqitje e saktë.

-
- Vlerat e paraqitura tek “Hyrja e parasë së gatshme në llogari të thesarit” linja “Të hyrat vetanake” tek kolona “Realizimi” janë paraqitur gabimisht prej 320,788 Euro, përderisa të hyrat vetanake për periudhën Janar- Dhjetor 2014 kanë qenë 375, 020 Euro. Si pasojë e një paraqitjeje të tillë edhe shumat e shënimit 15- Të hyrat vetanake nuk barazohet me shumat e paraqitura në këtë pasqyrë.
 - Në Shënimin 16 “Grante dhe ndihma” janë paraqitur të hyrat nga Granti i donatorëve në vlerë prej 18,000 Euro, përderisa vlerat e paraqitura tek Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit, përkatësisht tek linja Donacionet në kolonën “Realizimi” janë 159, 261 Euro.
 - Në shënimin 31 “Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale me vlerë mbi 1,000 Euro në posedim të Organizatës Buxhetore” vlera e paraqitur ka një diferencë me regjistrin e pasurive kapitale prej 46,000 Euro.
 - Burimi kryesor dhe i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar dhe raportuar gjithë shpalosjet të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme. Këto shpalosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe detyrimet e papaguara dhe kontigjente.
 - Mes totalit të numrit aktual të punëtorëve sipas PVF 2014 dhe listave të pagave, llista e pagave ka një diferencë prej 45 punëtorësh më shumë në fund të vitit 2014.

Rreziku

Paraqitja jo e saktë e pasqyrave financiare dhe shënimeve dhe gabimeve në shumat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të Komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.

Rekomandimi 5

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që procesi i përgatitjes të PVF-ve plotësisht adreson kërkesat e Rregullores MF - Nr. 03/2013. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve. Të gjitha kërkesat tjera të raportimit duhet të përmbushen.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Përshkrimi

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të Komunës së Dragashit kanë rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të adresohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, 1 rekomandime është adresuar pjesërisht dhe 12 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 6 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një nga rekomandimet e vitit të kaluar është zbatuar pjesërisht sepse Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal dhe të detajuar për të menaxhuar dhe monitoruar dhe për të kërkuar llogari për progresin e zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i vitit paraprak.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve të auditimit ka rezultuar me dobësi të vazhdueshme në sistemet kyçe financiare me pasoja si në vijim:

- Pajtueshmërinë me kërkesat për raportim;
- Realizim jo të mirë të buxhetit;
- Mangësi në procesin e qeverisjes;
- Menaxhim të dobët të të hyrave për shkak të mungesës së evidencave dhe raportimeve të brendshme;
- Mangësi në procesin e prokurimit;
- Regjistër jo të plotë të pasurive;
- Mangësi në trajtimin e parasë së gatshme;
- Trajtim jo i duhur i shpalosjeve të llogarive të arkëtueshme;
- Trajtim jo i duhur i shpalosjeve të borxheve;
- Përfitim të limituar nga puna e Auditimit të Brendshëm;
- Mangësi lidhur me raportimin e pagave dhe mëditjeve;
- Trajtim jo i duhur i shpalosjeve i pagesave nga palë të treta;

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të sigurojë një plan të veprimit, të rishikuar, për adresimin e rekomandimeve të mbetura të vitit 2013 dhe ato të vitit 2014. Ky plan duhet të përcaktojë qartë një afat të arsyeshëm kohor të implementimit, stafin përgjegjës dhe mënyrën e zbatimit, duke u fokusuar fillimisht në fushat me rëndësi të madhe dhe aty ku janë identifikuar dobësi domethënëse. Progresi kundrejt planit duhet të monitorohet direkt nga ana e Kryetarit të Komunës.

4. Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është e fokusuar në kuptimin dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti, për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll. Ne vlerësojmë nëse kontrollet janë dizajnuar mirë, janë implementuar sipas planit apo funksionojnë në mënyrë efektive. Për ta bërë këtë nevojitet vlerësimi i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të paraqitura nga menaxhmenti. Ne konsiderojmë çështje të veçanta siç janë: aplikimi i vetë-vlerësimit të MFK-së dhe vlerësimi i rrezikut.

Ne konsiderojmë se megjithëse ka pasur përmirësime pozitive në disa fusha të kontrollit të brendshëm në vitin e fundit, ne kemi identifikuar që kërkohen edhe përmirësime specifike në fushat në vijim:

- Kontrollet mbi përgatitjen e Raportit Financiar (Nëntëmujor dhe Vjetor)ë
- Kontrollet lidhur me inventarizimin, vlerësimin dhe prezantimin e pasurive kapitale;
- Kontrollet mbi procedurat e prokurimit;
- Kontrollet mbi menaxhimin e llogarive të arkëtueshme;
- Kontrollet mbi menaxhimin e llogarive të pagueshme;
- Kontrollet mbi menaxhimin e të hyrave;
- Kontrollet mbi menaxhimin e dosjeve të personelit.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrimi

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 7 - Kontrollat menaxheriale- Prioritet i lartë

- E gjetura** Rishikimi që ne i kemi bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të Komunës ka nxjerrë në pah dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë. Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me kontrollet mbi: përgatitjen e Raportit Financiar (Nëntëmujor dhe Vjetor), inventarizimin, vlerësimin dhe prezantimin e pasurive kapitale, procedurat e prokurimit, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, menaxhimin e llogarive të pagueshme, menaxhimin e të hyrave, menaxhimin e dosjeve të personelit.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë dhe menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e Komunës, si dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet t'i rishikojë masat ekzistuese të qeverisjes së përgjithshme dhe cilësinë e raportimeve të brendshme të Komunës. Kërkesat e pazbatuara duhet të adresohen deri në fund të vitit 2015. Cilësia e raportimeve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar arritjen e objektivave të Komunës.

Çështja 8 - Ndarja e detyrave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Nuk është bërë ndarja e duhur e detyrave dhe përgjegjësi pasi Zyrtari certifikues i pasurisë njëkohësisht është edhe zyrtar për pranimin e parasë së gatshme.
- Rreziku** Meqenëse i njëjti zyrtar pranon dhe dorëzon paratë e gatshme në bankë, gjithashtu bën edhe regjistrimin e pasurive kapitale në Free balance, mund të mos sigurohet kontroll i mjaftueshëm mbi pasuritë dhe as kohë e mjaftueshme për mbulimin e gjithë funksioneve të caktuara.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që të ketë ndarje të përshtatshme të detyrave.

4.2. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Dragashit, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	6,452,646	7,348,741	6,607,016	5,786,000	5,504,000
Granti i Qeverisë -Buxheti	6,011,646	6,522,486	6,355,767	5,309,000	5,062,000
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	217,086	87,312	189,000	92,000
Të hyrat vetanake ³	441,000	441,000	145,937	158,000	192,000
Donacionet e brendshme	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	168,169	18,000	130,000	158,000

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 896,095 Euro. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme në vlerë prej 168,169 Euro dhe të hyrave të bartura nga viti paraprak në vlerë prej 217,086 Euro. Gjithashtu, Granti i Qeverisë është rritur për 510,840 Euro, pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2014, Komuna ka përdorur 90% të buxhetit final ose 6,607,016 Euro (2013: 94% ose 5,786,000 Euro). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,452,646	7,348,741	6,607,016	5,786,000	5,504,000
Pagat dhe Mëditjet	3,252,000	3,857,209	3,791,943	3,264,000	3,236,000
Mallrat dhe Shërbimet	640,064	730,672	508,582	517,000	455,000
Shërbimet komunale	130,000	134,000	108,020	116,000	105,000
Subvencionet dhe Transferet	35,000	35,000	35,000	45,000	42,000
Investimet Kapitale	2,395,582	2,591,859	2,163,471	1,844,000	1,666,000

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në shifrat më sipër në kategorinë e Investimeve Kapitale mund të vërehet një realizim prej 83% (2013: 88%). Kjo kategori përfshin disa projekte të reja për vitin aktual, si ndërtimi i rrugëve në Restelicë, ndërtimi i ujësjellësit kryesorë, kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllavë, etj.
- Sa i përket realizimit të shpenzimeve të kategorisë Paga dhe Mëditje, mund të vërehet një realizim i mirë i buxhetit prej 98% (2013: 99%), edhe pse kjo pjesërisht e reflekton ngritjen e pagave prej 25% të zbatuar në prill 2014, gjë që nuk është reflektuar në buxhet. Sikurse organizatat tjera buxhetore, Komuna e Dragashit duhet të adresojë si këtë rritje ashtu edhe reduktimin prej 25% në Mallra dhe Shërbime.
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në vlerën 168,169 Euro, të cilat ishin alokuar për Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, dhe Investime Kapitale konkretisht për realizimin e projektit “Ndërtimin e shtegut të ecjes në kuadër të zhvillimit të turizimit” si dhe projektit “Vetëdijsimi mbi menaxhimin e mbeturinave” të financuara nga UNDP. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është vetëm 11% ose 18,000 Euro. Shkaqet e mosrealizimit të buxhetit nga grantet e donatorëve qëndrojnë në faktin se mjetet prej 138,958 Euro nga donatori - Unioni Evropian janë pranuar në fund të muajit dhjetor 2014.

Tabela 3. Të hyrat vetanake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat vetanake	441,000	441,000	233,249	357,000	365,000

Sa i përket të hyrave vetanake, mund të vërehet se përqindja e realizimit është vetëm 53% deri me 31 dhjetor 2014 (88%: 2013). 33% e të hyrave vetanake janë të hyra nga tatimi në pronë të cilat gjatë vitit janë inkasuar 91% nga të hyrat në pronë të buxhetuara.

Çështja 9 - Realizimi i të hyrave vetanake - Prioritet i lartë

E gjetura Të hyrat vetanake për këtë periudhë janë realizuar në nivelin 53% të buxhetit, në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit paraprak, të hyrat vetanake janë më të ulëta për 35%.

Rreziku Për Komunën, mos-përmbushja e programit të vet kapital do të rezultojë në shfrytëzimin joefikas të burimeve dhe mos-arritjen e planeve buxhetore të Komunës.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.

Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguruar se janë ndërmarrë të gjitha masat për mbledhjen e këtyre të hyrave.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga Komuna në vitin 2014 ishin në total 233,249 Euro. Kjo kategori përfshinë të hyrat nga tatimi në pronë, tatimi administrativ dhe rrugor, lejet e ndërtimit, etj.

Komuna ka një gamë kontrollesh që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e disa llojeve të të hyrave. Megjithatë, ekziston nevoja për përmirësim në disa procese për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së të hyrave.

Çështja 10- Tatimi në Pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk ka kryer anketime të të gjithë pronave të reja në vitin 2014, dhe as ri anketimin e 1/3 të pronave ekzistuese të regjistruara. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë sipas Udhëzimit Administrativ 07/2011, që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj tatim paguesve që nuk paguajnë detyrimet.

Rreziku Mungesa e anketimit dhe e verifikimit për 1/3 e pronave mund të ndikojë që Komuna mos të ketë të dhëna të sakta e të plota të pronës së tatueshme aktuale, dhe rrjedhimisht ndikon që të hyrat nga tatimi në pronë të ulen. Gjithashtu mos kushtëzimi i ofrimit të shërbimeve me pagesën e borxheve aktuale e ulë mundësinë e inkasimit të borxheve.

Rekomandimi 10 Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që anketimet dhe kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të bëhen në baza të tilla siç kërkohet nga ligji në fuqi.

Çështja 11 - Mungesa e Kontratave - Prioritet i mesëm

E gjetura Komuna nuk i ka vazhduar kontratat e qiramarrësve të objekteve të Komunës të cilët kanë borxhe të papaguara nga vitet paraprake ndaj Komunës, por të njëjtit qiramarrës vazhdojnë aktivitetin e tyre në objekte të Komunës. Komuna vazhdon të bëjë kërkesë për arkëtimin e qirasë pa u bazuar në një kontratë për vitet 2010 - 2014.

Rreziku Shfrytëzimi i pronave të Komunës nga qiramarrësit pa kontrata dhe pagesa përkatëse mund të sjellë humbje dhe mosshfrytëzim të pasurive për Komunën.

Rekomandimi 11 Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurojë që të përgatiten kontratat për të gjithë shfrytëzuesit e pronave publike të Komunës.

4.4. Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Kontratat e nënshkruara përmes procedurave të prokurimit për vitin 2014 ishin në vlerë prej 2,381,523 Euro. Këtu përfshihen Investimet Kapitale dhe Mallrat dhe Shërbimet.

Janë disa aspekte të procesit të prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive.

Çështja 12 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i lartë

E gjetura

Auditimi ynë mbi menaxhimin e prokurimit identifikoi çështjet në vijim (konkluzionet tona bazohen nga vlerësimi i dosjeve individuale dhe detajet e plota i janë ofruar menaxhmentit):

- Në një kontratë në vlerë prej 20,000 Euro, njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik (OE) të ofrojë sigurimin e tenderit në vlerë 10% të kontratës. Ne konstatuam se kompania fituese nuk kishte përmbushur këtë kërkesë. Gjithashtu, OE kishte ofruar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 7% të vlerës së kontratës dhe jo 10% siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042.
- Në një kontratë në vlerë prej 73,863 Euro ne konstatuam se kompania fituese kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit të tenderit një ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe jo para nënshkrimit të kontratës, siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës.
- Në nëntë kontrata në vlerë totale prej 397,156 Euro ne kemi vërejtur se operatorët ekonomik nuk kanë arritur t'i përfundojnë punët brenda afatit të kontratës dhe planit të menaxhimit, siç ishte përcaktuar në dosjen e tenderit. Në bazë të kontratës, në rastet kur punët nuk përfundojnë sipas afatit të kontratës dhe planit të menaxhimit, Komuna duhet të aplikoj ndëshkime prej 0.5% mbi përfituesin ekonomik. Ne konstatuam se Komuna nuk ka aplikuar asnjë ndëshkim.
- Në tri kontrata në vlerë totale prej 89,000 Euro data e përfundimit të punës sipas kontratës dallon me atë në planin e menaxhimit. Në dy kontratat e para data e përfundimit të punës në planin e menaxhimit është pas datës së kontratës, ndërsa në kontratën e tretë data e përfundimit të punës në planin e menaxhimit është para datës së kontratës.
- Sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L- 042 për çdo aktivitet të prokurimit të autoritetit kontraktues, Kryetari i Komunës duhet të caktoj një person që të shërbejë si Zyrtar Autorizues për atë aktivitet të prokurimit. Ne konstatuam se të gjitha kontratat të cilat kanë qenë objekt i auditimit, nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë.

-
- Në të gjitha prokurimet e testuara gjatë auditimit Autoriteti kontraktues nuk ka plotësuar siç duhet vlerësimin final të nevojave dhe përcaktimit të fondeve, përkatësisht fushëveprimin dhe objektivat dhe Shtojcën 1: Specifikacionet funksionale.
 - Në të gjitha prokurimet e testuara gjatë auditimit Komisioni i Vlerësimit të tenderëve është caktuar nga zyrtari i prokurimit. Kryetari i Komunës ka autorizuar me një vendim, zyrtarin e prokurimit që të bëjë këto caktime. Përderisa sipas Udhëzuesit Operacional për prokurimin publik zyrtari për prokurim mund të bëjë rekomandime për anëtarët e komisionit të vlerësimit por është Kryetari i Komunës që duhet të bëjë aprovimin e anëtarëve të këtij komisioni.
 - Në tri kontrata në vlerë totale prej 266,995 Euro siguria e tenderit nuk është sipas limitit të përcaktuar nga Ligji mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042. Në të tri rastet vlera e sigurisë së tenderit është më pak se 3% e vlerës së parashikuar të kontratës publike.

Rreziku

Si rezultat i procedurave të dobëta të prokurimit, mund të bëhen pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, vlerë e dobët për paranë e shpenzuar, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandimi 12

Kryetari i Komunës duhet të kryejë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar.

4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit

Çështja 13 - Zotimi i mjeteve pas datës së kontratës - Prioritet i mesëm

E gjetura Në kategorinë “Mallra dhe shërbime” në 4 raste, zotimi i mjeteve është bërë pas datës së faturës së pranuar. Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/ 2013 /MF – “Shpenzimi i parave publike”, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak të mjeteve.

Rreziku Për shkak të mos zotimit të fondeve para nënshkrimit të kontratës apo para datës së faturës, Komuna mund të hyj në detyrime të cilat mund të mos jetë në gjendje t’i paguaj.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë që për çdo kërkesë blerje të ketë fillimisht fondet e zotuar në mënyrë që Komuna të mos hyj në obligime pa siguruar fondet e mjaftueshme.

4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Shpenzimet për Paga dhe Mëditje paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel lokal kanë të bëjnë me: a) autorizimin e listës së pagave; b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme; dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Kemi vërejtur mungesë të dokumentacionit dhe gabim në llogaritjen e ndalesës për pushimin e lehonisë.

Çështja 14 – Dosjet e personelit - Prioritet i mesëm

E gjetura

Gjatë auditimit të dosjeve të personelit, kemi hasur ne mungesë të disa dokumenteve të cilat kërkohen me Rregulloren Nr. 03/2011 “Mbi dosjet dhe regjistrin qendror për shërbyesit civil”. Dokumentet të cilat kanë munguar janë:

- Në 11 raste Aktet e Emërimit për shërbyesit civil nuk e kanë të përcaktuar Gradën siç kërkohet me Ligjin 03/ L - 14 si dhe rregulloren 03/ 2011.
- Në 2 raste Aktet e Emërimit për shërbyesit civil nuk e kanë të përcaktuar Koeficientin siç kërkohet me rregulloren 03/ 2011.
- Në dosjet e punëtorëve të cilat kanë qenë objekt i auditimit mungojnë dokumentet që kërkohen me rregulloren 03/2011 si: Kopje e kartës së identitetit për 13 punëtorë, dëshmia profesionale për 5 punëtorë, dokumentet me rastin e rekrutimit për 10 punëtorë, certifikata e lindjes për 4 punëtorë si dhe dëshmia e gjykatës që shërbyesit civil nuk janë nën hetime për 5 punëtorë.
- Kontrata e punës për 2 shërbyes civil nuk përmban të dhëna për lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër siç kërkohet me Ligjin 03/L -212.
- Në dosjet e drejtorisë së arsimit të ekzaminuara kemi hasur një rast në të cilin mungonte kontrata e punës së të punësuarit, prandaj ne nuk kemi arritur te marrim informata nëse paga sipas listës se pagave ishte e njejta sipas marrëveshjes.
- Mungojnë CPO-të (Urdhër pagesa për paga dhe shtesa) për këto departamente: Departamenti i Administratës Shëndetësore për muajin shkurt, Departamenti i Kulturës dhe Sportit për muajin prill dhe Departamentit për Komunitete për muajin qershor.
- Në të gjitha kontratat mes Drejtorisë së Arsimit dhe punëtorëve të arsimit të cilat kanë qenë objekt i auditimit tonë, nuk është paraqitur paga bruto.
- Nuk ka Akt Emërimi për Drejtorët e shkollave, por vetëm kontratë.
- Kryetari i Komunës ne baza mujore gjate vitit 2014 është paguar 119 Euro më shumë se maksimumi i lejuar me Udhëzimin Administrative 16/2008.
- Zëvendës Kryetari i Komunës ne baza mujore gjate vitit 2014 është paguar 71.25 Euro më shumë se maksimumi i lejuar me Udhëzimin Administrative 16/2008.

Rreziku

Mungesa e dokumentacionit në dosjet e personelit dhe mungesa e nënshkrimeve/aprovimeve të kërkuara është në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu mospërfillja e procedurave dhe kompletimit të dokumentacionit sipas rregullave mbi procesin e rekrutimit rrezikon që Komuna të punësojë punonjës të pa kualifikuar për pozitat përkatëse.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të ndërmarrë një rishikim sistematik të dosjeve të personelit, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda në dosje.

Çështja 15 – Llogaritja e ndalesave për pushimet e lehonisë - Prioritet i lartë

E gjetura E gjetura Llogaritja e ndalesave për pushimin e lehonisë nuk është bërë sipas ligjit të punës. Ne kemi vërejtur disa gabime që janë bërë te pagat nga Ministria e Administratës Publike dhe Komunitat që ka të bëjë me llogaritjen e pagës bazë në arsim si dhe përllogaritjen e ndalesave në pagë për pushimet e lehonisë. Kjo ndërlidhet me faktin se paga bazë në arsimin parauniversitar nuk është ndryshuar në sistem që nga viti 2010 edhe pse kishte dy herë rritje të pagës bazë sipas vendimeve të qeverisë. Rritja e parë ishte në janar 2011 për 50% dhe rritja e dytë në mars 2014 për 25% në pagën bazë. Këto ndryshime nuk ishin reflektuar në payroll në kolonën e pagës bazë por vetëm si shtesë e përfshirë në pagën bruto. Problemi qëndron se payroll zbaton standard të dyfishtë me rastin e kalkulimit të pagës bazë. Rritja e pagave në vitin 2014 është aplikuar mbi pagën bazë të vitit 2011 ndërsa me rastin e kompensimit të lehonave, payroll aplikon ndalesën prej 30% në pagën bazë të vitit 2010 duke i lejuar kështu lehonës 70% të pagës bazë (2010) dhe duke i shtuar edhe dy rritjet që kishin ndodhur, të cilat i trajtonë si shtesa në pagë. Sipas ligjit të punës, lehonat duhet të paguhet nga punëdhësi gjashtë muajt e parë me 70% të pagës bazë. Si pasojë e moszbatimit të ligjit të punës në lidhje me ndalesat për pushimin e lehonisë buxheti komunal është dëmtuar për rreth 227 Euro për vitin 2014.

Rreziku Mos aplikimi në mënyrë të rregullt i ndryshimeve të pagave në pagën bazë si dhe ndalesat e gabuara të shtesave gjatë pushimit të lehonisë rrezikon që me rastin e kompensimit të lehonave të dëmtohet tutje buxheti i Komunës.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të sigurojë se kjo çështje do të merret tutje në konsideratë nga administrata e Payroll-it, në mënyrë që të mos lejohet dëmtimin e buxhetit të Komunës. Kryetari duhet të adresojë këtë çështje tek MAP-i që të bëhet ndryshimi në pagën bazë në pajtueshmëri me vendimet e qeverisë dhe ndryshimet të reflektohen në sistemin e pagave tek arsimi para universitar.

4.4.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna ka shpërndarë 35,000 Euro subvencione apo 100% të buxhetit të planifikuar. Realizimi i tërësishëm i planit të subvencionimit varet kryesisht nga inkasimi i të hyrave vetanake.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Edhe pse Komuna ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar raportimin për pasuritë e saj, ekzistojnë ende disa pasiguri dhe mangësi në lidhje me pasuritë e Komunës dhe janë adresuar vetëm pjesërisht rekomandimet e viteve paraprake.

Çështja 16 –Regjistri i pasurive kapitale - Prioritet i lartë - Prioritet i lartë

E gjetura Regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000 Euro, nuk përmban datën e saktë kur pasuria është vënë në funksion, por vetëm vitin e blerjes së pasurisë, si rrjedhojë ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi dhe respektivisht vlera neto e pasurive e paraqitur në shënimin 31 është e saktë.

Rreziku Për shkak se pasuritë kapitale mbahen në vlerën neto në shpalosjen për pasuritë kapitale në posedim të organizatës buxhetore, llogaritja jo e duhur e zhvlerësimit mund të ndikojë në paraqitjen jo të drejtë të vlerës neto të pasurive kapitale në këtë shënim.

Rekomandimi 16 Kryetari duhet të sigurohet që regjistri i pasurive kapitale të përmbajë informata të plota, duke përfshirë datën kur pasuria është vënë në funksion, në mënyrë që përlllogaritja e zhvlerësimit të mund të bëhet dhe të jetë e saktë.

Çështja 17 – Shpalosja e pasurive kapitale nën 1,000 Euro - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk ka të instaluar sistemin për mbajtjen e pasurisë nën 1,000 Euro “E- Pasuria”. Për më tepër Komuna nuk ka një regjistër të detajuar për pasuritë jo kapitale nën 1,000 Euro. Vlera e paraqitur në Shënimin 32 “Përmbledhja e Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1,000 Euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit” bazohet në inventarizimin vjetor që Komuna ka bërë për pasuritë jo kapitale ku janë përfshirë vetëm Administrata Komunale, Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe 2 shkolla.

Po ashtu, pasuritë e paraqitura në shënime 32 “Përmbledhja e Përmbledhja e pasurive jokapitale me vlerë nën 1000 Euro dhe me afat të përdorimit më shumë se një vit” mbahen me koston bazë, dhe Komuna nuk ka bërë llogaritjen e zhvlerësimit për këto pasuri.

Rreziku Mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe mos kryerja e inventarizimit të plotë për pasuritë jo kapitale në posedim të organizatës buxhetore mund të ndikojë në paraqitjen jo të saktë të informatave në Pasqyrat Financiare. Kjo mund të rezultojë në mbajtjen e pasurive jo kapitale në pasqyrat financiare me vlerë jo reale apo në mbajtjen e pasurive të cilat mund të jenë të dëmtuara apo nuk ekzistojnë. Gjithashtu, paraqitja e pasurive në vlerën bruto nuk është në përputhje me Rregulloren për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Rekomandimi 17 Kryetari duhet të sigurohet që Komuna të mbajë informata të sakta dhe të plota në lidhje me pasuritë jo kapitale, që inventarizimi i pasurisë të bëhet në tërësi dhe të sigurohet që pasuritë zhvlerësohen sipas Rregulloren MF-Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”.

4.5.2 Trajtimi i parasë së gatshme (dhe ekuivalentëve të parasë së gatshme)

Përshkrim

Para e gatshme nuk dorëzohet në bankë në baza ditore.

Çështja 18 – Vonesa në depozitimin e parasë në bankë- Prioritet i mesëm

E gjetura Paraja e gatshme e arkëtuar nga qytetarët për të gjitha shërbimet, nuk dorëzohet në bankë në baza ditore.

Rreziku Mungesa dhe vonesat në depozitim e parave në bankë nga Komuna mund të sjellin keqpërdorim të parave dhe gabimeve të pidentifikuara në raportimin e parasë së gatshme.

Rekomandimi 18 Kryetari duhet të sigurohet që të paratë të depozitohen në bankë në baza ditore.

4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk ka zbatuar një proces të mjaftueshëm për planifikimin, identifikimin, raportimin dhe arkëtimin e faturave të lëshuara për taksat e saj.

Çështja 19 – Vjetërsia e llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

E gjetura Shumica e llogarive të arkëtueshme të paraqitura në shënimin 35- “Të arkëtueshmet” lidhen me vitet e mëparshme. Komuna nuk mbanë një raport të vjetërsisë së këtyre borxheve, si dhe nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për të mbledhur këto shuma dhe nuk ka kryer analiza për vjetërsinë e tyre.

Rreziku Mungesa e kontrolleve të mjaftueshme mbi arkëtimin e të hyrave dhe e informacionit për vjetërsinë e shumave të arkëtueshme ndikon negativisht mbi mbledhjen e të hyrave dhe si rezultat edhe mbi fondet që Komuna gjeneron për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e saj. Këto mungesa pengojnë identifikimin e problemeve, monitorimin dhe përqendrimin e burimeve të duhura në arkëtimin e të hyrave, dhe prezantimin në pasqyrat financiare të shumave të sakta dhe të plota që pritet të mblidhen.

Rekomandimi 19 Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa të mëtjeshëm për përmirësimin e kontrolleve dhe se vepron në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve vendore lidhur me arkëtimin e të hyrave.

4.5.4 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014 ishte 70,000 Euro. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2015.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu veçmas. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit etj.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) ka një plan vjetor të auditimit, edhe ka kryer 4 auditimet e planifikuara të vitit 2014. Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet vetëm nga një auditor përkatësisht drejtorit të NjAB, që është nën minimumin e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 23/2009.

Gjithashtu, rekomandimi i auditorit të vitit paraprak në lidhje me Komitetin e Auditimit, i cili në raportin e auditimit të vitit paraprak është kritikuar meqë anëtarët e këtij Komiteti kanë qenë punonjës të Komunës ka vazhduar të funksionojë në të njejtën mënyrë.

Çështja 20 – Burime të pamjaftueshme të stafit në njësinë e brendshme të auditimit- Prioritet i lartë

E gjetura Njësia e Auditimit të Brendshëm përbëhet nga një auditore që njëkohësisht është edhe Drejtoreshë e njësisë. Sipas udhëzimit administrativ 23/2009 organizatat buxhetore me buxhet më të madh se 5,000,000 Euro duhet të angazhojnë së paku tre auditor të brendshëm.

Nuk ka plan kohor në përcjelljen e rekomandimeve të NjAB dhe menaxhmenti nuk ka dizajnuar planin për adresim të këtyre rekomandimeve.

Rreziku Mungesa e kapaciteteve në NjAB rrezikon në një program të papërfunduar dhe zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me funksionimin e sistemeve financiare. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që rezulton me humbje financiare për Komunës së Dragashit.

Rekomandimi 20 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore për këtë njësi dhe për të arritur përfitimet maksimale nga puna e Komitetit të Auditimit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-kualifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të kualifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të kualifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të kualifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në cilën pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është kualifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
<p>Pajtueshmëria me kërkesat për raportim financiar dhe</p> <p>Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm</p>	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurohet se përgatitja e pasqyrave financiare do të përfshijë procedura dhe mjete të projektuara për t'u siguruar që informatat e kërkuara janë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyra financiare.</p> <p>Informacioni mbi pagesat nga palët e treta, shumat e të arkëtueshmeve dhe detyrimeve kontigjente duhet të përditësohet rregullisht dhe të rishikohet për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e shpalosjeve të tilla në pasqyrat financiare.</p> <p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna raporton në kohë Indikatorët e Performancës.</p>			Për t'u zgjidhur
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet që të sigurohet që të ketë ndarje të përshtatshme të detyrave.			Për t'u zgjidhur
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.			Për t'u zgjidhur

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit (vazhdim)	<p>Nëse supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final dhe para përcaktimit të programit kapital për vitin e ardhshëm.</p> <p>Kryetari duhet të sigurohet se plani i realizimit të të hyrave vetanake përbën plan realist dhe përkon me mundësitë e Komunës për mbledhjen e të hyrave. Për më shumë duhet siguar se janë ndërmarrë gjithë masat për mbledhjen e këtyre të hyrave.</p>			Për t'u zgjidhur
Të hyrat vetanake (përfshirë të hyrat vetanake)	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë risqe të mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurojë sa vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimin e një sistemi faturimi që përfshin detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe vlerësimin e arkëtimit. Një informacion i tillë duhet të kenë vetëm një numër i limituar i personash dhe të autorizuar nga drejtimi. • Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet. 			Për t'u zgjidhur

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Të hyrat vetanake (përfshirë të hyrat vetanake) (vazhdim)	<ul style="list-style-type: none"> • Ndërlidhja automatike e sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit. • Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen rakordime të rregullta mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ekzekutohet një volum i lartë transaksionesh. • Regjistrimi i të hyrave vetanake në kategorinë e duhur dhe zbatimi i kontrolleve të tilla si rishikimi i rregullt i klasifikimit, në mënyrë që të sigurohet një prezantim i saktë i të ardhurave të tilla në pasqyrat financiare. • Të intensifikohet aktiviteti dhe të bëhet identifikimi dhe regjistrimi i kërkuar i pronës së tatueshme. • Të përgatiten kontrata për të gjithë shfrytëzuesit e pronave publike të Komunës. 			Për t'u zgjidhur
Prokurimi	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuna do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të sigurojë që i gjithë dokumentacioni i kërkuar është marrë dhe paraqitur në mënyrë rigoroze në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale. • Do të bëhet një rishikim i të gjeturave të auditimit sipas të cilave proceset nuk janë aplikuar në mënyrë efektive, si dhe ta përcaktojë se pse kanë ndodhur dështimet në to. Veprimet/proceset e duhura duhet të implementohen për të siguruar se dështimet e tilla nuk do të ndodhin në të ardhmen. 			Për t'u zgjidhur

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna raporton informacionet të plota lidhur me pagat dhe mëditjet dhe zbaton kërkesat për miratim të pagesave.			Për t'u zgjidhur
Pasuritë kapitale dhe jokapitale- Pasiguri në lidhje me Nenin 16, Shpalosja e pasurive	Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës dhe të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme Komuna regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pasuritë, si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.			Për t'u zgjidhur
Pasuritë kapitale dhe jokapitale- Pagesat nga palët e treta	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna po bën përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta, me theks të veçantë tek ato palë që dihet se kanë kryer investime të rëndësishme në Komunë. Të dhënat e siguruara duhet të paraqiten drejt në regjistrin e pasurive të Komunës. Praktika e mirë do të kërkonte që në baza vjetore të bëhet barazimi i të dhënave mes palëve të treta dhe Komunës për investimet në Komunë për vitin përkatës.			Për t'u zgjidhur
Trajtimi i parasë së gatshme (vonesa në depozitimin e parasë në bankë)	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se do të depozitohen dhe kontrollohen rregullisht paratë në banka në fund të çdo dite.			Për t'u zgjidhur
Trajtimi i të arkëtueshmeve	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna ndërmerr hapa të mëtijshëm për përmirësimin e kontroleve dhe se vepron në përputhje me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve vendore lidhur me arkëtimet e të hyrave.			Për t'u zgjidhur

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
Sistemi i auditimit të brendshëm	<p>Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të zbatojë politika dhe procedura të përshtatshme për të siguruar një standard të lartë të qeverisjes. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontabilitetin e Komunës dhe proceset e raportimit financiar; • Vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi; • Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm; • Strukturat e kontrollit, përputhshmërisë dhe raportimit në gjithë Komunën, duhet të sigurojnë pajtueshmërinë me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore; dhe • Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të Auditimit të Brendshëm. <p>Ne këshillojmë që Kryetari duhet të bëjë një Plan Veprimi që duhet zbatuar për të siguruar se puna e auditimit të brendshëm është bërë dhe raportuar mbi një bazë kohore dhe për të adresuar rekomandimet e rezultuara, detajon oficerët përgjegjës dhe afatin kohor për zbatim.</p> <p>Kryetari duhet të punojë me Auditimin e Brendshëm për të siguruar aktivitete të mjaftueshme mbi sistemet financiare të vitit, para se të nxirret drafti i PVF-ve. Përbushja e aktiviteteve të planifikuara të auditimit duhet të monitorohet çdo dy muaj dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet të adresohen në kohën e duhur.</p>		Pjesërisht e zgjidhur	

Shtojca III: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave të auditimit

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 3 – Mungesë e dokumentacionit të pronësisë për investimet e bëra nga palët e treta</p> <p>Gjatë vitit 2014, Komuna nuk ka pranuar një raport zyrtar të detajuar prej palëve të treta lidhur me investimet që ato kanë bërë në Komunë gjatë viteve të mëparshme.</p>		<p>Më qëllim të regjistrimit të pagesave nga palët e treta Komuna ka kërkuar nga palët e treta – agjencitë e ndryshme dhe shoqatat që të paraqesin raport të detajuar mbi investimet në Komunë. Edhe përkundër kërkesave, raporte të tilla nuk kemi pranuar përpos Marrëveshjeve mbi bashkëfinancim të projekteve.</p>	<p>Komuna duhet të parasheh barazimin me palët e treta në momentin e lidhjes së marrëveshjeve për financime ose bashkëfinancime. E gjetura mbetet e vlefshme.</p>
<p>Çështja 4 dhe 5 – Pajtueshmëria me PFV</p> <ul style="list-style-type: none"> Komuna në “Pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme” ka paraqitur si pranime shumë të realizuara/alokuara (shuma që është në dispozicion për t’u shpenzuar) në vlerë prej 7,190,000 Euro përderisa është dashur të paraqesë si pranim shumë aktuale të shpenzimeve të bërë në emër të LIVTH në shumë prej 6,607,016 Euro. <p>Si pasojë e një paraqitjeje të tillë edhe shumat e shënimeve 2- Granti qeveritar, 3- Të hyrat vetanake, 4- Grantet dhe ndihmat, 7 - Paga dhe rroga, 8- Mallra dhe shërbime,</p>	Pajtohemi	<p>Sipas Nenit 12, pika 3 e Rregullës Financiare për PVF 03/2013 të Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme , shuma që paraqitet si burim i fondeve është shuma aktuale e shpenzimeve të bëra përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara. Kështu, është vepruar për PVF të vitit paraprak , por në PVF të vitit 2014 pa dashje është bërë lëshim që konsiderojmë se duhet merret për bazë dhe</p>	<p>Gabimi teknik është material. Menaxhmenti duhet të shqyrtoj raportin financiar për përmbajtjen dhe saktësinë, duke përfshirë edhe anën teknike. E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 4 dhe 5 - Pajtueshmëria me PFV (vazhdim)</p> <p>9- Shërbime komunale dhe 11 - Shpenzimet kapitale, nuk barazohen me shumatat e paraqitura në këtë pasqyrë, pasi që në shënime janë paraqitur shumatat e shpenzuara që është një paraqitje e saktë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerat e paraqitura tek “Hyrja e parasë së gatshme në llogari të thesarit linja Të hyrat vetanake” tek kolona “Realizimi” janë paraqitur gabimisht prej 320,788 Euro, përderisa të hyrat vetanake për periudhën Janar- Dhjetor 2014 kanë qenë 375,020 Euro. Si pasojë e një paraqitjeje të tillë edhe shumatat e shënimit 15- Të hyrat vetanake nuk barazohet me shumatat e paraqitura në këtë pasqyrë. • Në Shënimin 16 Grante dhe ndihma janë paraqitur të hyrat nga Granti i donatorëve në vlerë prej 18,000 Euro, përderisa vlerat e paraqitura tek Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thezarit, përkatësisht tek linja Donacionen në kolonën “Realizimi” janë 159,261 Euro. 		<p>arsyetim. Në këtë pasqyrë është paraqitur shuma prej 7,190 Euro shumë kjo e pranuar për tu shpenzuar ndërsa duhet të shënohet shuma prej 6,607 Euro që paraqet shumën totale të shpenzimeve.</p> <p>Shuma prej 320,788 Euro është paraqitur tek kolona Realizimi nga se 54,000 Euro të cilat paraqesin të hyrat e muajit dhjetor nuk i janë alokuar organizatës buxhetore deri në përfundim të afatit për dorëzimin e këtyre pasqyrave. Kjo shumë prej 54,000 Euro është alokuar në muajin shkurt 2015.</p> <p>Të shënimi 16 Grantet dhe ndihmat nuk janë të paraqitura të hyrat por shpenzimet nga grantet e donatorëve.</p>	<p>Shuma prej 375,020 euro paraqet shumën e alokuar.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p> <p>Shumat në shënimet e pasqyrës duhet të jenë të barabarta me shumatat në pasqyrë.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 4 dhe 5 - Pajtueshmëria me PFV (vazhdim)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në shënimin 31 "Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale në posedim të Organizatës Buxhetore" vlera e paraqitur ka një diferencë me regjistrin e pasurive kapitale prej 46,000 Euro; Burimi kryesor dhe i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance, i cili nuk përdoret për të regjistruar dhe raportuar gjithë shpalosjet të cilat nuk raportohen sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme. Këto shpalosje përfshijnë të hyrat nga gjobat, pagesat nga palët e treta, të arkëtueshmet dhe detyrimet kontigjente. 		<p>Edhe gjatë procesit të auditimit kemi zhvilluar biseda rreth kësaj çështje dhe ju kemi rekomanduar që disa shpenzime të paguara nga kategoria e investimeve kapitale nuk mund të konsiderohen si pasuri financiare dhe atë për shkak që:</p> <ol style="list-style-type: none"> Mbikqyrja e ekzekutimit të projekteve nuk konsiderohet pasuri por është shërbim që është paguar nga investimet kapitale, Pastrimi i lumenjëve dhe mbeturinave nuk konsiderohen pasuri financiare por janë shërbime në mbrojtjen e ambientit dhe mjedisit. <p>Të hyrat nga gjobat në trafik, nga gjykata dhe nga dënimet mandatore, janë të hyra të nivelit qëndror, por që këto të hyra u alokohen komunave. Këto të hyra në SIMFK nuk i regjistron komuna por niveli qendror që komunat nuk kanë qasje në to. Të dhënat</p>	<p>Diferenca sipas të gjeturës nuk lidhet me ndonjë shpenzim të paguar nga kategoria e investimeve që nuk mund të konsiderohet pasuri jo financiare.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p> <p>E gjetura jonë ka të bëjë me faktin se Free Balance nuk siguron plotësi të informacionit të kërkuar për raportimit financiar dhe nuk</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 4 dhe 5 - Pajtueshmëria me PFV (vazhdim)</p>		<p>regjistrohen sipas raporteve të cilat i dërgon Ministria e Financave. Po kështu edhe të hyrat nga palët e treta dhe detyrimet kontigjente nuk regjistrohen në sistem.</p>	<p>mund të përdoret i vetëm për të gjeneruar pasqyra financiare. E gjetura mbetet e vlefshme</p>
<p>Çështja 8 - Ndarja e detyrave</p> <p>Nuk është bërë ndarja e duhur e detyrave dhe përgjegjësive pasi Zyrtari certifikues i pasurisë njëkohësisht është edhe zyrtar për pranimin e parasë së gatshme.</p>		<p>Për shkak të vëllimit të vogël të punëve dhe detyrave të punës të zyrtarit për para të imëta, ky zyrtar është i angazhuar edhe për regjistrimin e pasurisë komunale në SIMFK.</p>	<p>Nga angazhimi në funksione të ndryshme mund të mos sigurohet kontroll i mjaftueshëm mbi pasuritë dhe as kohë e mjaftueshme për mbulimin e gjithë funksioneve të caktuara. E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 10 - Tatimi në pronë</p> <p>Komuna nuk ka kryer anketime të gjithë pronave të reja në vitin 2014, dhe as rianketimin e 1/3 të pronave ekzistuese të regjistruara. Gjithashtu Komuna nuk ka zbatuar kushtëzimin e pagesës së tatimit në pronë sipas Udhëzimit Administrativ 07/2011, që detyron mos ofrimin e shërbimeve komunale ndaj tatim paguesve që nuk paguajnë detyrimet.</p>	<p>Pajtohemi pjesërisht</p>	<p>Është e vërtetë se Komuna nuk ka kryer anketimin e të gjitha pronave të reja nga viti 2014 dhe as rianketimin e 1/3 e pronave ekzistuese të regjistruara nga shkak se një punëtor nuk ka mund të arrij të bëjë anketimin. Një kohë të gjatë aparatet GJPS nuk kanë funksionuar. Pas furnizimit me aparate të rinj është bërë ri anketimi i një pjese të pronave. Sa i përket zbatimit të UA mbi ndalimin e ofrimit të shërbimeve komunale për personat që nuk paguajnë tatimin në pronë-aplikimi i kushtëzimeve është duke u aplikuar sidomos të bartja dhe transferi i pronës dhe regjistrimi i automjeteve por nuk mund të thuhet se ky zbatim është i shkallës 100%.</p>	<p>Komuna duhet të jetë në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 12 - Dobësi në prokurim</p> <p>Auditimi ynë mbi menaxhimin e prokurimit identifikoi çështjet në vijim (konkluzionet tona bazohen në vlerësim të dosjeve individuale dhe detajet e plota i janë ofruar menaxhmentit):</p> <ul style="list-style-type: none"> Në një kontratë në vlerë prej 20,000 Euro, njëri nga kriteret e vendosura në dosjen e tenderit ishte që operatori ekonomik (OE) të ofrojë sigurimin e tenderit në vlerë 10% të kontratës. Ne konstatuam se kompania fituese nuk kishte përmbushur këtë kërkesë. Gjithashtu, OE kishte ofruar sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 7% të vlerës së kontratës dhe jo 10% siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042. 		<p>Është e saktë që sigurimi i ekzekutimit të punëve është kërkuar 10% e projektit, ndërsa Operatori Ekonomik ka ofruar sigurimin prej 7% të vlerës së kontratës. Mirëpo kjo është bërë për shkakun se tenderi ka qenë për njësi dhe se vlera e përafërt që i është dhënë operatorëve ekonomik është kalkuluar deri në vlerën prej 14,828 Euro ose rreth 7% të vlerës së projektit, ndërsa punimet janë realizuar në fund deri në vlerën 20,000 Euro. Kjo është edhe arsyeja pse Operatori Ekonomik ka dhënë sigurimin deri në 7% të vlerës së projektit.</p>	<p>Llogaritja e vlerës së përafërt duhet të jetë sa më reale nga aspekti i kostos. Siguria e ekzekutimit kërkohet të jetë të paktën 10% e vlerës së kontratës.</p> <p>Gjetja mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 12 - Dobësi në prokurim (vazhdim)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në një kontratë në vlerë prej 73,863 Euro, ne konstatuam se kompania fituese kishte dorëzuar sigurimin e ekzekutimit të tenderit një ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe jo para nënshkrimit të kontratës, siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës. Në nëntë kontrata në vlerë totale prej 397,156 Euro ne kemi vërejtur se operatorët ekonomik nuk kanë arritur t'i përfundojnë punët brenda afatit të kontratës dhe planit të menaxhimit, siç ishte përcaktuar në dosjen e tenderit. Në bazë të kontratës, në rastet kur punët nuk përfundojnë sipas afatit të kontratës dhe planit të menaxhimit, Komuna duhet të aplikoj ndëshkime prej 0.5% mbi përfituesin ekonomik. Ne konstatuam se Komuna nuk ka aplikuar asnjë ndëshkim. Në tri kontrata në vlerë totale prej 89,000 Euro ne konstatuam se data e përfundimit të punës sipas kontratës dallon me atë në planin e menaxhimit. Në dy kontratat e para data e përfundimit të punës në planin e menaxhimit është pas datës së kontratës, ndërsa në kontratën e tretë data e përfundimit të punës në planin e menaxhimit është para datës së kontratës. 		<p>Është bërë një lëshim teknik në sigurimin e tenderit për ekzekutimin e punëve një ditë me herët se dita kur është duhej të nënshkruhet kontrata. Thjeshtë pra është lëshim teknik.</p> <p>Është e vërtetë që Kompanitë janë vonuar në realizimin e punimeve, por një faktorë për vonesa në trevën e Komunës tonë është se gjatë sezonës së verës është traditë që të behën dasmat, andaj në të gjitha fshatrat ku janë zhvilluar punimet me ditë të tëra gjatë ceremonisë së dasmave atë ditë nuk lënë qytetarët të punohet. Ndërsa është një lëshim nga organi mbikëqyrës që nuk i ka paraparë gjatë përpilimit të ditarit të punëve këto vonesa, por besojmë që vitin e ardhshëm do të eliminohen këto lëshime dhe do të veprojmë sipas rekomandimit.</p>	<p>Ne rekomandojmë që Komuna të sigurohet që mos të ketë lëshime teknike në të ardhmen.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p> <p>Komuna duhet të sigurohet që punët e kontraktuara të përfundojnë sipas planit në të ardhmen ose të aplikohen masat ndëshkuese për vonesat.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 12 - Dobësi në prokurim (vazhdim)</p> <ul style="list-style-type: none"> Në tri kontrata në vlerë totale prej 266,995 Euro siguria e tenderit nuk është sipas limitit të përcaktuar nga Ligji mbi Prokurimin Publik Nr. 04/L-042. Në të tri rastet vlera e sigurisë së tenderit është më pak se 3% e vlerës së parashikuar të kontratë publike. 		<p>Sipas Ligjit të Prokurimit siguria e tenderit është nga 3-5 % të vlerës së kontratës, por jo me pak se 1,000 Euro. Kjo është bërë për shkakun që të rumbullaksohet një vlerë e përafërt e jo të kërkohet me vlerë sipas kontratës.</p>	<p>Ne rekomandojmë që siguria e tenderit të jetë sipas kërkesave të Ligjit mbi Prokurimin Publik. E gjetura mbetet e vlefshme.</p>
<p>Çështja 13 - Zotimi i mjeteve pas datës së kontratës</p> <p>Në kategorinë “Mallra dhe shërbime” në 4 raste, zotimi i mjeteve është bërë pas datës së faturës së pranuar. Sipas rregullës financiare Nr. 01/ 2013 /MF – “Shpenzimi i parave publike”, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak të mjeteve.</p>	<p>Nuk pajtohemi</p>	<p>Është e vërtetë se zotimi i mjeteve është bërë pas datës së faturës dhe kjo është e shprehur sidomos të furnizimet me karburante. Zotimi i mjeteve bëhet pas faturës nga se furnizimi është i rregulluar me kontratë. Po kështu, disa shkolla kanë bërë furnizime pa zotim të mjeteve por rastet janë të vogla dhe nuk mund të thuhet se mungon dokumentacioni.</p>	<p>Sipas Rregullës 01/2013 “Shpenzimi i parave publike” OB nuk duhet të hyjnë në obligime kontraktuale pa zotimin e fondeve në sistemin SIMFK, dhe i njëjti duhet të jetë pjesë e kontratës. Edhe LMFPK kërkon që para inicimit të një procesi të prokurimit i cili ka për qëllim ngritjen e një obligimi në vitin</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 13 - Zotimi i mjeteve pas datës së kontratës</p>			<p>aktual fiskal, OB regjistron të gjitha zotimet e fondeve të ndara në SIMFK në përputhje me rregullat e MFK. E gjetura mbetet e vlefshme.</p>
<p>Çështja 14 - Dosjet e personelit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në 11 raste të cilat ne i kemi testuar Aktet e Emërimit për shërbyesit civil nuk e kanë të përcaktuar Gradën siç kërkohet me Ligjin 03/ L - 14 si dhe rregulloren 03/ 2011. • Në 2 raste, Aktet e Emërimit për shërbyesit civil nuk e kanë të përcaktuar Koeficientin siç kërkohet me rregulloren 03/ 2011. • Në dosjet e punëtorëve të cilat kanë qenë objekt i auditimit mungojnë dokumentet që kërkohen me rregulloren 03/2011 si: Kopje e kartës së identitetit për 13 punëtorë, dëshmia profesionale për 5 punëtorë, dokumentet me rastin e rekrutimit për 10 punëtorë, certifikata e lindjes për 4 punëtorë si dhe dëshmia e gjykatës që shërbyesit civil nuk janë nën hetime për 5 punëtorë. • Kontrata e punës për 2 shërbyes civil nuk përmban të dhëna për lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër siç kërkohet me Ligjin 03/L -212. 	<p>Pjesërisht</p>	<p>Me rregulloren mbi sistematizimin e vendeve të punës ,përcaktimi i pagave bëhet në bazë të koeficienteve aktual të përcaktuar me Rregulloren e Ministrisë, dhe kontratat-aktemërimet e punëtorëve lëshohen në bazë të koeficientve mbi përcaktimin e pagave. Gradimi do të jetë me Rregulloren e re e cila pritet të implementohet pas vendimit të Qeverisë.</p> <p>Lidhur me mungesën e dokumenteve të identifikimit si kopja e kartës së identifikimit, dëshmia profesionale për punëtorë, dokumente e rekrutimit; ka të bëjë me punëtorët të cilët janë pranuar para vitit 1999 e para.</p>	<p>Të gjeturat tona janë bazuar në gjendjen e dosjeve të personelit të cilat i kemi ekzaminuar gjatë punës sonë në terren në Komunë, dhe të njejtat të gjetura i janë komunikuar zyrtarit të personelit në auditimin nëntëmujor dhe final.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 14 - Dosjet e personelit</p> <ul style="list-style-type: none"> Në dosjet e drejtorisë së arsimit të ekzaminuara kemi hasur një rast në të cilin mungonte kontrata e punës së të punësuarit, prandaj ne nuk kemi arritur të marrim informata nëse paga sipas listës së pagave ishte e njëjta sipas marrëveshjes. Mungojnë CPO-të (Urdhër pagesa për paga dhe shtesa) për këto departamente: Departamenti i Administratës Shëndetësore për muajin shkurt, Departamenti i Kulturës dhe Sportit për muajin prill dhe Departamentit për Komunitete për muajin qershor. Në të gjitha kontrata mes Drejtorisë së Arsimit dhe punëtorëve të arsimit të cilat kanë qenë objekt i auditimit tonë, nuk është paraqitur paga bruto. Nuk ka Akt Emërimi për Drejtoret e shkollave, por vetëm kontratë. Kryetari i Komunës është paguar 119 Euro më shumë se maksimumi i lejuar me Udhëzimin Administrative 16/2008. Zëvendës Kryetari i Komunës është paguar 71.25 Euro më shumë se maksimumi i lejuar me Udhëzimin Administrative 16/2008 	Pjesërisht	Lartësia e pagës për shërbyesit civil përcaktohet në bazë të koeficientëve. Në aktemërim është përcaktuar koeficienti.	

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
<p>Çështja 15 - Llogaritja e ndalesave për pushimet e lehonisë</p> <p>Llogaritja e ndalesave për pushimin e lehonisë nuk është bërë sipas ligjit të punës. Ne kemi vërejtur disa gabime që janë bërë te pagat nga Ministria e Administratës Publike dhe Komunitet që ka të bëjë me llogaritjen e pagës bazë në arsim si dhe përlllogaritjen e ndalesave në pagë për pushimet e lehonisë. Kjo ndërlidhet me faktin se paga bazë në arsimin parauniversitar nuk është ndryshuar në sistem që nga viti 2010 edhe pse kishte dy herë rritje të pagës bazë sipas vendimeve të qeverisë. Rritja e parë ishte në janar 2011 për 50% dhe rritja e dytë në mars 2014 për 25% në pagën bazë. Këto ndryshime nuk ishin reflektuar në payroll në kolonën e pagës bazë por vetëm si shtesë e përfshirë në pagën bruto. Problemi qëndron se payroll zbaton standard të dyfishtë me rastin e kalkulimit të pagës bazë. Rritja e pagave në vitin 2014 është aplikuar mbi pagën bazë të vitit 2011 ndërsa me rastin e kompenzimit të lehonave, payroll aplikon ndalesën prej 30% në pagën bazë të vitit 2010 duke i lejuar kështu lehonës 70% të pagës bazë (2010) dhe duke i shtuar edhe dy rritjet që kishin ndodhur, të cilat i trajtonë si shtesa në pagë. Sipas ligjit të punës, lehonat duhet të paguhet nga punëdhënsi gjashtë muajt e parë me 70% të pagës bazë. Si pasojë e moszbatimit të ligjit të punës në lidhje me ndalesat për pushimin e lehonisë buxheti komunal është dëmtuar për rreth 227 Euro për vitin 2014.</p>	Pjesërisht	<p>Me ngritjen e pagave prej 25% për shërbyesit civil dhe stafin politik , struktura e përcaktimit të pagave me UA 16/2008 ndryshon sepse rritja e pagave reflekton në ndryshimin e strukturës për pagat e stafit politik.</p> <p>Ndryshimet eventuale që kanë pasuar në përlllogaritjen e pagave të lehonisë janë si rrjedhim i ndryshimeve në sistemin e Payrollit dhe nuk janë në ingerence të programeve të OB kur ka të bëjë me përcaktimin e pagës bazë.</p>	<p>Komuna të sigurohet që llogaritjet të bëhen mbi pagën bazë dhe të njoftohet MAP lidhur me gabimin në llogaritjen e ndalesave për lehonat.</p> <p>E gjetura mbetet e vlefshme.</p>

Të gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar në rast të mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte Kosova sh.p.k
